



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME DETARE  
KAPITENERITE E PORTEVE & KONTROLLI SHTETËROR PORTUAL  
KONTROLLI SHTETËROR PORTUAL**

Nr. 123/1 Prot.

Durrës, më 25 / 01 / 2024

**RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS  
SË SEKTORIT TE KONTROLLIT SHTETËROR PORTUAL  
PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2023**

Sektori i Kontrollit Shteteror Portual(KSHP) kryen veprimtarinë e tij duke u bazuar ne Ligjin nr. 9251 dt.08.07.2004 “**Kodi Detar i Republikes se Shqiperise**”, Ligjin nr.10109 date 02.04.2009, “**Për administratën detare të RSH**”,Ligjin nr.9852,date 26.12.2007 “**Per Aderimin e Shqipërisë në Memorandumin e Mirkuptimit per Kontrollin Shtetëror Portual**”, Vendimit nr.13,date 11.01.2017 per Miratimin e Rregullores” **Per Kontrollin Shteteror Portual ne Republiken e Shqiperise**”dhe **Udhezim Nr.883,dt21.12.2018**, Për përcaktimin e kushteve,procedurave dhe afateve te vlefshmerisë se licensave per ushtrimin e veprimtarisë së transportit kombëtar dhe ndërkombëtar detar për automjetetdhe/ ose udhetare dhe shkaqet e procedurat e pezullimit apo revokimit të tyre, si dhe në mbështetje të kërkesave të parashikuara në Konventat Ndërkombëtare Detare si pas tipit të anijeve dhe moshës së tyre.

**Gjatë vitit 2023** Sektori Kontrollit Shtetëror Portual ka realizuar një volum të konsiderueshëm pune persa i përket zbatimit të programit vjetor dhe kontratës së performancës për kryerjen e inspektimeve në anijet me flamur të huaj që prekin portet e hapura të RSH.

**-Gjatë periudhës Janar- Djetor 2023**, kanë prekur portet e hapura të Republikës së Shqipërisë,të paktën një herë, dhe janë përpunuar gjithsej **593 anije** me flamur të huaj të tipeve të ndryshme,përveç anijeve pasagjere të linjës.Nga këto, **372 anije mallrash** të përgjithshme,**84 anije konteiner** dhe **137 anije çisternë**.Sektori i Kontrollit Shtetëror Portual nëpërmjet inspektorëve dhe specialistëve që ka në organikë gjatë vitit **2023** ka kryer gjithsej **163 inspektime** në portet Durrës, Vlorë dhe Shëngjin. Gjatë këtij viti janë kryer gjithsej **22 inspektime në anijet pasagjere** që operojnë në linjat ndërkombëtare për transportin e

pasagjerëve dhe mjeteve. Inspektimi në anijet pasagjere është kryer për efekt licensimi **15 anije**, rifutje në linjë dhe inspektime rutinë sipas rasteve të paraqitura **08 anije**

Nga **593 anije** që kanë prekur portet e hapura të RSH, **235 anije** kanë prekur portet e hapura të RSH për herë të parë ose plotësonin kriteret për inspektim. Janë kryer gjithsej **163 inspektime që përkon me 70% të anijeve të inspektuara**. Pjesë e anijeve që nuk janë inspektuar ka të bëjë me faktin që janë përpunuar gjatë ditëve të pushimit në fundjave dhe gjatë festive zyrtare, janë përpunuar shumë shpejt dhe koha e qëndrimit në port ka qënë shumë e shkurtër (sidomos anijet konteniere) dhe një pjesë e mirë e anijeve kanë qënë të reja dhe me risk të ulët (sidomos anijet çisterna).

**Në zbatim të objektivit:** *“Kryerja e inspektimeve në të gjitha anijet me flamur të huaj me nivel të lartë risku”.*

-Ç`do ditë nga ora 08:00 deri në orën 08:30 është bërë takimi I punës me inspektorët dhe specialistët e sektorit të KSHP të portit Durrës dhe është diskutuar mbi situatën portuale në të gjitha portet e hapura të RSH. Inspektori i Portit Vlorë që ka dhe si detyrë për të raportuar dhe situatën e anijeve që prekin Portin e Sarandës . Ndërsa Porti i Shëngjinit raportimi i situatës bëhet nga inspektorët e Portit Durrës I dërgojnë informacionet e tyre, mbi situatën portuale të porteve respektive, me email. Gjatë takimit të punës është marë prezenca e inspektorëve dhe specialistëve të sektorit është , përcaktuar risku I të gjitha anijeve në rada dhe në porte dhe të gjitha këto dokumenta ruhen në dosjen e hapur për këtë qëllim në zyrën e Sektorit të KSHP.

-Në përfundim të vlerësimit të situatës është përcaktuar numri dhe lloji I anijeve që do të inspektohen. Gjatë planifikimit të inspektimeve vëmendje kryesore i është kushtuar anijeve që prekin portet e hapura të RSh për herë të parë, anijeve me moshë më të madhe se 12 vjet si dhe anijeve të cilat e kanë të ndaluar të futen në portet e shteteve të Komitetit Evropian. Ky grup anijesh konsiderohet me performancë të lartë risku (high risk). Janë inspektuar të gjitha anijet me këtë performance.

-Është miratuar nga epërori, plani I punës me emrat e inspektorëve dhe specialistëve që do të kryejnë inspektimet.

**-Gjatë periudhës Janar- Djeto 2023**, kanë prekur portet e hapura të RSH gjithsej **22 anije me nivel të lartë risku** dhe janë inspektuar **20 prej tyre, ose 91% të anijeve me këtë risk**. Janë identifikuar të gjitha mangësitë në bordin e anijeve të inspektuara (**201 mangësi të ndryshme**) dhe është lëshuar dhe dokumentuar raporti I inspektimit, një kopje e raportit të inspektimit i është lënë kapitenit në bord për çdo anije

**-Në zbatim të objektivit:** *“Kryerja e inspektimeve në anijet pasagjere me flamur të huaj që prekin portet e hapura të RSh në linjë të rregullt ndërkombëtare për transport pasagjerësh dhe mjetesësh”.* Në bazë të **Udhezimit Nr.883, dt 21.12.2018**, Për përcaktimin e kushteve, procedurave dhe afateve të vlefshmerisë së licensave për ushtrimin e veprimtarisë së transportit kombëtar dhe ndërkombëtar detar për automjetet dhe/ ose udhetare dhe shkaqet e procedurat e pezullimit apo revokimit të tyre, si dhe në mbështetje të kërkesave të parashikuara në Konventat Ndërkombëtare Detare si pas tipit të anijeve dhe moshës së tyre.

**-Gjatë periudhës Janar- Djetor 2023**, kanë kryer aktivitetin e tyre për transportin e pasagjerëve dhe mjeteve në linjë ndërkombëtare gjithsej **13 anije pasagjere** . Janë kryer gjithsej **22 inspektime** në bordin e anijeve pasagjere që operojnë në linjat ndërkombëtare për transportin e pasagjerëve dhe mjeteve në linjat Durrës-Bari-Durrës , Durrës -Ankona- Durrës, Vlorë-Brindisi-Vlorë. Nga inspektimet e kryera janë identifikuar gjithsej **72 mangësi të ndryshme**. **15 Inspektime** janë kryer për efekt licensimi,**pjesa tjetër e inspektimeve** janë kryer për hyrje në linjë mbas një periudhe ndërprerje dhe rutinë me qëllim verifikimin e gjëndjes teknike të mjeteve.

**-Në zbatim të objektivit;** *“Kryerja e inspektimeve në anijet me flamur të huaj që plotësojnë kriteret për inspektim sipas parashikimeve të VKM Nr.13,datë 11.01.2017 kryesisht anijeve container dhe anijeve çisternë”.*

**-Gjatë periudhës Janar- Djetor 2023**, kanë prekur të paktën një herë portet e hapura të RSH **137 anije çisternë dhe 84 anije konteniere**. Nga këto **20 anije çisternë dhe 10 anije konteniere** i plotësonin kriteret për inspektim sipas parashikimit në rregulloren e KSHP.Janë inspektuar **2 anije konteniere ose 20% e tyre dhe 7 anije çisternë ose 35 % e tyre** .Përsa i përket inspektimit të anijeve konteinere sektori jonë nuk ka bërë të gjitha inspektimet e paraqitura pasi hasim vështirësi në inspektimin e tyre për arsyen se këto tip anijesh përpunohen në një kohë shumë të shkurtër,e cila e bën realisht të vështirë inspektimin e plotë të tyre.Nga informacionet dhe kontaktet që kemi me inspektorë të vendeve anëtare të Paris MoU, rezulton se edhe këto vende shprehin të njëjtin shqetësim përsa u përket inspektimit të anijeve konteniere. Përsa i përket inspektimit të anijeve cisternë, pjesa më e madhe e këtyre anijeve që përpunohen në терминаlet tona janë prodhime të viteve të fundit me moshe 2-5 vjecare.

**-Në zbatim të objektivit;** *“Uljen e numrit të anijeve që largohen pa u inspektuara”.*

Përgjithësisht anijet që nuk janë inspektuar janë anijet konteniere dhe anijet çisternë.Anijet konteniere përpunohen shumë shpejt në port. Këto anije paraqesin nivel standart dhe të ulët risku. Ndërsa anijet çisternë janë në moshë të re dhe kanë nivel të ulët dhe shumë të ulët risku.

-Mbas inspektimeve të kryera është vënë re se, përgjithësisht anijet nuk kanë mungesa në dokumentacionin e tyre apo në dokumentacionin e ekuipazhit. Pjesa më e madhe e anijeve të inspektuara,kryesisht ato me moshë me te madhe, kane pasur probleme me mirmbajtjen e përgjithshme te anijes pasi në shumë raste vihet re prezenca e ndryshkut në bordet kryesore të tyre,apo korrodime te pjesëve te ndryshme te saj. Gjatë inspektimeve të kryera vëmëndje të veçantë i është kushtuar pajisjeve dhe çertifikimit të mjetevetë shpëtimit të jetës në det,të mjeteve të luftës kundër zjarrit,si dhe kushteve të punës dhe të jetës të ekuipazhit,të cilat,përgjithësisht,në të gjitha anijet e inspektuara kanë qënë relativisht të mira konform rregullave nderkombëtare detare të përcaktuara në Konventat përkatëse të IMO.

Gjatë muajit janar është bërë **një inspektim** në anijen cisternë Queen Majeda e bllokuar pranë portit Durrës, pasi u mor leje nga Prokuroria durrës.

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2023 janë **kryer tre inspektime** në anije kondinjer mbas marjes së informacionit për mundësi ndotje detare nga QNOD.

Janë inspektuar **dy anije** mbas ardhjes së informacionit nga dy memorandume të ndryshme. Gjatë inspektimit në **një anije** që raporti për defekt në mtorin kryesor (Flamur Cameroon dhe Shoqëri Klasifikues Shipping Register of Ukraine prodhimi vitit 2009), u njoftua shoqëria klasifikues dhe nuk u lejua të largohet nga porti pa u riparuar dhe të konfirmuar nga shoqëria klasifikuese.

-Gjatë vitit 2023 Sektori KSHP nëpërmjet Inspektorët dhe Specialistët Ka marë pjesë në Grupe Pune dhe komisione të ngritur me urdhër te brendshëm nga Drejtori i Përgjithshem.

- Në komision testimi për detarët (STCË)
- Në komision testimi për drejtues mjete të vogla drejtuese.
- Në auditimin e qëndrave të trajnimit të detarëve.
- Në auditimin e qëndrave për trajnimin e drejtuesve të mjeteve të vogla detare.

- Gjatë vitit 2023, sekori i Kontrollit Shtetëror Portual ka qënë pjesë e përfaqësuesve të Drejtorisë së Përgjithshme Detare në takimin “Taiex – vizitë studimore” –në Maltë me qëllim procedurat e auditimeve dhe trajnimeve të kurseve të detarëve në zbatim të Konventës së Organizatës Ndërkombëtare Detare (IMO) “Për standardet e trajnimit, certifikimit dhe vrojtimit për detarët” si akteve ligjore dhe nënligjore ndërkombëtare që rrjedhin prej saj me qëllim Njohjen e Certifikatave të Detarëve nga Malta (Bashkimi Evropian).

-Gjatë vitit 2023 Sektori I KSHP ka kryer disa trajnime:

- Preparatory session to IMSAS - Albania. Organizuar nga EMSA.
- Regional Eorkshop on Facilitation of International Maritime Traffic. Organizuar nga IMO
- Trajnime online në portalin e EMSA , MacK and Rule Check.

Problematikat:

- Sistemi i Bazave të të dhënave për trafikun Detar Shqiptar, si një nga portalet ku Kshp grumbullon të dhëna mbi anijet që operojnë në portet e R.Sh ,nuk ka qënë i plotësuar plotësisht.
- Mungesa e nje mjeti tarnsporti .

Vështirësi në Inspektimin e Anijeve Konteniere: Inspektimet e anijeve konteniere janë të vështira për shkak të kohës së shkurtër qëndrimi të tyre në port, çka bën të pamundur një inspektim të plotë dhe të detajuar.

Mangësi të Identifikuara në Anijet e Inspektuara: Gjatë inspektimeve janë zbuluar disa mangësi në mirmbajtjen e përgjithshme të tyre.

Ulja e Numrit të Anijeve të Larguara pa U Inspektuara: Një objektiv i KSHP ka qenë të zvogëlojë numrin e anijeve që largohen pa u inspektuara, veçanërisht ato me risk të lartë ose standart, si dhe anijet konteniere dhe çisternë.

Këto problematika pasqyrojnë sfidat me të cilat do të përballlet KSHP në monitorimin dhe sigurimin e standardeve të duhura në anijet që prekin portet e Shqipërisë.

Bashkangjitur do të gjeni:-

- 1- Lista e anijeve që kanë prekur radat dhe portet e hapura të Republikës së SHqipërisë
- 2-Tabela përmbledhëse vjetore e inspektimeve që janë kryer për anije të ndryshme.
- 3-Tabelat mujore të inspektimevetë anijeve të ndryshme.
- 4-Tabela përmbledhëse vjetore e inspektimeve që kanë kryer për anijet Ro-Ro Pax.
- 5- Tabelat mujore të inspektimevetë anijeve Ro-Ro Pax.

## **SEKTORI I KONTROLLI SHTETEROR PORTUAL**

**Përgjegjësi I Sektorit**

**KASTRIOT SALI**